- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-23-4357-5-2-1/C883

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nenl. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj . Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitim të sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës .
	17.2	Përfundimi i të gjitha punëve do të jetë për 385 ditë, brenda 24 muajve, sipas urdhëresës së menaxherit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 36 muaj
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Numri i Prokurimit: 632-23-4357-521 – Titulli: *Renovimi dhe adaptimi i shkollës Zef Lush Marku-Brekac*

Aneksi - 6.1

AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE

Për: **KOMUNA E GJAKOVËS**
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [**TRIANGLE shpk Rr. Brigada 123 pn Suharekë**]
(në vazhdim: "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: *Renovimi dhe adaptimi i shkollës Zef Lush Marku-Brekac*

Numri i Prokurimit: 632-23-4357-5-2-1

Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Afatin e Implementimit të projektit dhe Periudhën Garantuese

DERISA ne si tenderues kemi ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një ofertë në të cilën kriteri i dhënies është Tenderit Ekonomikisht Më i Favorshëm (TEMF), bazuar në nën kriteret për PERIUDHËN GARANTUESE dhe AFATIN E IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT, DEKLAROJMË se do të përmbushim kërkesat e Autoritetit Kontraktues për këtë projekt për një periudhat e përcaktuara si më poshtë:

I. AFATI I IMPLEMENTIMIT të këtij projekti është:

385 ditë, nga data e fillimit të punëve e përcaktuar nga Menaxheri i Kontratës.
Shëno numrin e ditëve

II. PERIUDHA GARANTUESE vlen 3 vite nga data e pranimit të përkohshëm të projektit

Shëno numrin e viteve
nga Autoriteti Kontraktues, për projektin e cekur në këtë deklaratë.

Arian Bytyçi

Emri i përfqësuesit të OE

Nënshkrimi

Vula



PARAMASA DHE PARALLOGARIA**RENOVIMI DHE ADAPTIMI I SHKOLLES " ZEF LUSHMARKU "****LOKACIONI: BREKOC-GJAKOVË****VËREJTJE:**

Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me çertifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv.

Ne të gjitha pozicionet përshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TË PËRFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NE DEPONI.

1 PUNËT NDËRTIMORE					
1.01 PUNËT PARAPREGADITORE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
1.01.01	Pergatitja e kompanise dhe bartja e pajiseve qe mundesojne realizimin e punimeve ne vendpunishte. Ne cmim te perfsihet dhe sigurimi i vendpunishtes per realizimin e punimeve ne menyren me te sigurte (rrethimi i punishtes).	paushall	1	5,000.00 €	5,000.00 €
1.01.02	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i njetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, njetit elektrik dhe ndriçimit të kantiert, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kablnave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1	1,000.00 €	1,000.00 €
TOTAL ME TVSH				1.01	6,000.00 €

1.02 PUNËT E DEMOLIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
1.02.01	Te behet demolimi i dritareve metalike se bashku me parapetet ne bodrum, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km distance.	cope	3.00	50.00	150.00
1.02.02	Te behet demolimi i deres metalike ne bodrum, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km distance.	cope	1.00	100.00	100.00
1.02.03	Te behet demolimi i dritareve nga materiali PVC se bashku me parapetet,dritaret gjinden ne katin perdhese dhe katin e pare(khina teknike,klase,koridore,laboratore,etj.), transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km distance.	cope	55.00	70.00	3,850.00
1.02.04	Te behet demolimi i deres metalike tek pjesa e kthines teknike, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km distance.	cope	1.00	10.00	10.00
1.02.05	Te behet demolimi i plafonit nga lthuprrat e drurit tek pjesa e kthines teknike, si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km distance.	m²	34.50	5.00	172.50
1.02.06	Të bëhet demolimi i murit ndares per hapjen e cila lidhe kthinon teknike me kthinën qe lidhet me shkollën.Dimensionet e hapjes duhet te jene 100x240cm. Plani i demolimeve eshte paraqitur tek pjesa grafike.Transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna.	m³	1.50	2.00	3.00
1.02.07	Te behet grryerja e suvatimit për gjatë gjithë sipërfaqes se perimetrit te mureve te brendshme tek pjesa e kthines teknike, si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km	m²	88.50	1.00	88.50
1.02.08	Te behet demolimi i derrasave eksluese ne dyshemen e kthines lidhese me kthinën e teknike, transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna.	m²	13.90	5.00	69.50
1.02.09	Te behet grryerja e suvase/shireses finale për gjatë gjithë sipërfaqes se perimetrit te mureve te brendshme dhe platoneve, si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km	m²	3660.50	0.10	366.05
1.02.10	Te behet demolimi komplet i gardhit metalik tek dy pale shkallet e brendshme, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km distance.	komplet	2.00	300.00	600.00



1.02.11	Te behet demolimi i dyshemes nga laminati/parketi duke perfshire llajset dhe nenshtresat ne te gjitha kihinat te cilat kane kete tip te dyshemes se dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km distance.	m ²	200.50	5.00	1,002.50
1.02.12	Te behet demolimi i soibankave te brendshme ekzistuese tek te gjitha dritaret ne komplet objektin, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km distance.	komplet	1.00	500.00	500.00
1.02.13	Te behet demolimi i dyerve nga materiali drurit ne katin e perdheses, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna	cope	2.00	10.00	20.00
1.02.14	Te behet demolimi i dyshemes nga parketi duke perfshire te gjitha shtraset nen te tek sofa e EDF duke perfshire llajset, si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km distance.	m ²	110.50	15.00	1,657.50
1.02.15	Te behet demolimi i ramit metalik tek dera ne hyrje te salles se EDF, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna	cope	1.00	50.00	50.00
1.02.16	Te behet demolimi i koshave te basketbollit, profilave anesore per rjeten e volejbollit si dhe pajisjeve per ushtrime ne perimete te salles, duke perfshire te gjitha konstruksionin ankerues te tyre, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km	komplet	1.00	100.00	100.00
1.02.17	Te behet demolimi i plafonit ekzistues nga knaufi te demtuar si dhe llamperia ne kihinat dhe koridorin e kati 1-re te cilat jane te parapara tek pjesa grafike, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km distance.	m ²	566.71	2.00	1,133.42
1.02.19	Te behet demolimi i dyshemes nga tepsoni tek kihina e qerdhes duke perfshire te gjitha shtraset nen te tek hapësira e qerdhes, si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km distance.	m ²	51.60	5.00	258.00
1.02.20	Të bëhet demolimi i mbulesës së kulmit deri në konstruksion mbajtës (konstruksion mbajtës i drurit nuk demolohet), duke perfshire tregullat, listat, llamarinat e perimete, etj. te objektit te shkolles dhe transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna.	m ²	1080.00	0.80	864.00
1.02.21	Të bëhet demolimi i konstruksionit mbajtës te kulmit (brinjëve dhe shingimeve) te cilat jane te kalbura, demtuara, etj. me qe raste edhe ka ardhur deri te shafitja e kulmit, te perfshihet edhe transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna.	m ²	150.00	2.00	300.00
1.02.22	Të bëhet demolimi i konstruksionit, mbulesës së kulmit te rafshit, duke perfshire ulluqet, lugjet, etj. te hyrja e objektit te shkolles dhe transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna.	m ²	16.50	5.00	82.50
1.02.23	Te behet demolimi i Antenes se vendosur ne kulem, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km distance.	komplet	1.00	100.00	100.00
1.02.24	Te behet demolimi i kapakeve eksitues per qasje ne kulem, transporti i mbeturinave deri ne deponine e percaktuar nga komuna deri 10km distance.	cope	2.00	10.00	20.00
1.02.26	Të bëhet demolimi i instalimeve elektrike duke perfshire të gjitha trupave ndriques ne perimete te objektit (ne fasaden ekzistuese). Mirepo instalimi (kabllo) te ruhen te mos demtohen si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna. Te ruhen kabllo ekzistuese ngase ato nuk nderrohen.	komplet	1.00	1,000.00	1,000.00
1.02.27	Të bëhet demolimi i llamarinës si dhe konstruksionit mbajtës per llamarinën e strehes ne perimete te objektit te shkolles (pjesa e vjeter) dhe transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna.	m	216.00	2.00	432.00
1.02.28	Të bëhet demolimi i ullukeve horizontal dhe vertikal nga llamarinat ne perimete te objektit dhe transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna.	komplet	1.00	50.00	50.00
1.02.29	Të bëhet demolimi i instalimeve elektrike duke perfshire të gjitha trupave ndriques, nderpresve, prizave, etj. në të gjitha kihinat e objektit dhe ne perimete te objektit si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna. Te ruhen kabllo ekzistuese ngase ato nuk nderrohen.	komplet	1.00	1,000.00	1,000.00
1.02.30	Të bëhet demolimi e betonave ne perimete te objektit si dhe tek pjesa perpara objektit si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna.		175.00	2.00	350.00



1.02.31	Të bëhet demolimi i oxhakeve ekzistues në komplet hapësirën e kulmit, demolimi i tyre të bëhet deri në nivel të pllakes së kulmit, si dhe të kthehet pjesa përpara objektit si dhe transporti i mbeturinave në deponinë e	cope	16.00	20.00	320.00
1.02.32	Të bëhet demolimi i mveshjes ekzistuese së pushimorës dhe shkalleve të jashtme për të dy hyrjet e shkolles, duke përfshirë gjithë shtresat deri në konstruksionin betonit, si dhe transporti i mbeturinave në deponinë e caktuar nga komuna deri në 10 km distance.	m ²	23.50	5.00	117.50
1.02.33	Të bëhet demolimi i mveshjes ekzistuese së pushimorës dhe shkalleve të brendshme, duke përfshirë gjithë shtresat deri në konstruksionin betonit, si dhe transporti i mbeturinave në deponinë e caktuar nga komuna deri në 10 km distance.	m ²	29.50	5.00	147.50
1.02.34	Të bëhet demolimi i mufës së akzistues me të gjitha aksesoret e saj, si dhe transporti i mbeturinave në deponinë e caktuar nga komuna deri në 10 km distance.	komplet	1.00	100.00	100.00
1.02.35	Të bëhet demontimi i këmave ekzistues, riparimi dhe rimontimi i tyre në pozitë që kanë qenë me heret para punimit të fasades.	cope	3.00	50.00	150.00
1.02.36	Të bëhet prerja/hapja e dyshemese për depërllimin e gypave të kanalizimit(drenazhimit) në dyshemë në bodrum.Të përfshihet edhe pashimi i komplet hapësirës së bodrumit me uje me presion.	komplet	1.00	25.00	25.00
1.02.37	Të bëhet largimi i perkoreshmë i inventarit(komika,tavolina,rafta,ormane,labeta,etj.) në një hapësirë tjetër të përcaktuar nga komuna deri në përfundimin e punimeve dhe pas përfundimit të punimeve të kthehen në objekt.Demtimet eventuale gjatë largimit/transportit janë përgjegjësi e punëkryesit.Si dhe të parashihet transporti i mbeturinave në deponinë e caktuar nga komuna	komplet	1.00	500.00	500.00
TOTAL ME TVSH			1.02	15,689.47 €	

1.03	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				
	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	TOTAL me tvsh
1.03.01	Të bëhet gërmimi i dheut tek kthina teknike në thellësi 0.35m' në nivelin e shkolles, transporti i mbeturinave deri në deponinë e përcaktuar nga komuna deri 10km distance.	m ³	13.00	5.00	65.00
1.03.02	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 20 cm me fraksion 0/31 në pllaken e dyshemese së kthinës teknike dhe kthinës që lidhet me shkollën duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në aniljen e kompaktësish Ms=30 MPa. Vërejtje: Për shkak të mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasia e llogaritur është rritur për 50%.	m ³	17.50	10.00 €	175.00
1.03.03	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 10 cm me fraksion 0/31 në tërë gjerësinë e betonave perimenter të shkolles si dhe tek pllatoja tek busi, duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm. Vërejtje: Për shkak të pasaktësive gjatë punës dhe mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasia e llogaritur është rritur për 50%.	m ³	45.00	10.00 €	450.00
TOTAL ME TVSH			1.03	690.00 €	

1.04	PUNËT E BETONIT				
	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI me tvsh	TOTAL me tvsh
1.04.01	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakes së dyshemese tek kthina teknike dhe kthinës që lidhet me shkollën me trashësi 10 cm.Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për aniljen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen armimi me aramitur rreth Q-335 ,të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kollëcat e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ²	7.50	95.00 €	712.50 €

1.04.02	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shërgut të ecjes në perimetër të shkollës me gjeresi 80 cm me trashësi 20 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës C-25/30 mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal Në çmim të përfshihen armimi me armaturë rreth Q-355, të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. Te punohen llogarit çdo 2 m dhe mbushja e tyre.	m ³	44.00	95.00 €	4,180.00 €
1.04.03	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i pilotave tek Busti "Zet Lushnarku", betonimi të bëhet me beton të markës C-25/30 mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	6.50	95.00 €	617.50 €
TOTAL ME TVSH				0.00	5,510.00 €

1.05	PUNËT E MURATIMIT				
	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	TOTAL me tvsh
1.05.01	Furnizimi me material dhe muratimi i murit tek pjesa ku do të vendoset erembrojtësi i ri, me trashësi 20cm me blloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaç të flluar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pilotës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtrëngim.	m ³	1.75	30.00 €	52.50 €
TOTAL ME TVSH				1.05	52.50 €

1.06	PUNËT E SUVATIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
1.06.01	Furnizimi me material, dhe suvatimi i sipërfaqeve të mbyllura me blloqe argjile, pjesa ku është vendosur erembrojtësi si dhe tek kthina teknike (total e zhveshur) deri në nivelin e plafonit me material të parapërzier si RÖFIX 510 (gëlqerë+cimento+agregat) ose material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaç sprucues RÖFIX 670 ose material të ngjashëm, listelat metalike për caklimin e trashësisë së llaçit, këndoret metalike, listelat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rjetë armimi dhe shirit vetngjilës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdhukshme me folie të PVC-së si dhe rjeta e PVC-së me fije qelqi për përfundimin e llaçit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si	m ²	95.50	3.00 €	286.50 €
1.06.02	Furnizimi me material dhe finalizimi i mureve si dhe plafonit të punuar nga knaufi të kthinave teknike me llaç finalizues të hollë të parapërzier me strukurë me trashësi 2mm (gëlqerë + cemento + agregat i mëd).	m ²	302.00	8.00 €	2,416.00 €
1.06.03	Furnizimi me material geryerja,rafshimi,dhe pafinimi i mureve me dy shtresa gjet-masë RÖFIX 225 ose material të ngjashëm në të gjitha kthinat në nivelin e përdhësës dhe katit 1 duke përfshirë edhe sallën e EDF të përcaktuara me projekt.	m ²	4,730.00	0.50 €	2,365.00 €
1.06.04	Furnizimi me material si dhe punimi i plafonit tek hapësira e kthinës teknike me pllaka knaufi me trashësi 12mm duke përfshirë edhe nenkonstruksionin metalik, me pas finalizohen me gjet dhe ngjyre. Ky pozicion i plafonit vendoset në mes të trajeve. Paraprakisht të bëhet edhe izolimi me tesh guri gjysëm të presuar t=5cm.	m ²	34.50	8.00 €	276.00 €
1.06.05	Furnizimi me material si dhe punimi i pllafoneve tek hapësira e klaseve dhe koridorit në katin e parë , me pllaka knaufi me trashësi 12mm (dy shtresor/2xpllaka) duke përfshirë edhe nenkonstruksionin metalik, me pas finalizohen me gjet dhe ngjyre. Ky pozicion i plafonit vendoset në mes të trajeve.Paraprakisht të bëhet edhe izolimi me tesh guri gjysëm të presuar t=10cm.	m ²	570.50	10.00 €	5,705.00 €
TOTAL ME TVSH				1.06	11,048.50 €



1.07 PUNËT E NGJYROSJES/KNAUFIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
1.07.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të patinuara me dy shtresa ngjyrë me bazë poliuretani me afërsi të madhe të postrimit si StoColor Puran. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyeje bazë/primer për enterier si StoPrim Plex për reduktimin e shkallës së apsorimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj.	m ²	5,637.00	2.00 €	11,274.00 €
1.07.02	Furnizimi dhe ngjyrosja e murave të këllave të brendshme me ngjyrë disperseive në 3 shtresa. Deri në lartësinë 1.6 m të aplikohet ngjyra e lyndyrshme.	m ²	460.80	2.50 €	1,152.00 €
				1.07	12,426.00 €

1.08 PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMESË					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
1.08.01	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit të këllave teknike në përdheshë për ngritjen në nivelin e dyshevesë së këllave fqinje. Në çmim të logaritit nivelizimi me ramje drejt ujëmbledhësve me: • Estrih t = deri 9 cm	m ²	48.40	10.00 €	484.00 €
				TOTAL ME TVSH	1.08 484.00 €

1.09 PUNËT E HIDROIZOLIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
1.09.01	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i hapësirave të këllave teknike dhe këllave që lidhen me shkollën në përdheshë. Në çmim duhet përfshirë hidroizolimin e dyshevesë në këto hapësira si dhe hidroizolimin e mureve perimetrike deri në lartësi 30 cm me hidroizolim të lëngshëm fleksibil dykomponentësh si Isomat Aquamat Flex të aplikuar në dy shtresa sipas udhëzimeve të prodhuesit. Posahtu në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëthurave të pafestuarit ose njetave me fije qelqi në kënde për të penguar plasatjen e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes me Durocret, Rapicret ose Adiplast. Gjate aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe afatet e përcaktuara nga prodhuesi.	m ²	48.50	8.00 €	388.00 €
				TOTAL ME TVSH	1.09 388.00 €

1.10 PUNËT E QERAMIKËS PORCELANIT GRANITIT KUARCHIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
1.10.01	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshevesë së këllave teknike me pllaka të paglazura porcelani me dimensione, ngjyrë dhe teksture/dizajn të përzgjidhen në koordinim me organin mbikqyrës të përcaktuar nga investitori. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes të klasit min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngjicave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrozionit dhe të përshtatshme për frekuencën të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus ose prodhues me karakteristika të ngjashme. me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave për të parandaluar sillkon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25 ose prodhues me karakteristika të ngjashme.	m ²	48.80	18.00 €	878.40 €



1.10.02	Furnizimi me material dhe punimi i caktës për mirëmbajtje më të lehtë të kthirave teknike të cilat janë të shtrura me pllaka porcelani. Coklla të punohet me pllaka të glazuara porcelani me lartësi 10 cm, me ngjyrë dhe teksturë/dizajn të njëjtë si ato të dyshemesë. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngjicave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjytja e pllakave të bëhet me ngjytës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 ose prodhues me karakteristika të ngjashme. Plus me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40 ose prodhues me karakteristika të ngjashme. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ¹	40.10	10.00 €	401.00 €
1.10.03	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë tok zyrove të stafit, klasave, laboratorëve dhe hapësirave tjera të brendshme të përcaktuara në projekt me pllaka të paglazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përzgjedhur në koordinim me organin mbikqyrës të përcaktuar nga investitori. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rëshqitjes të klasit min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngjicave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjytja e pllakave të bëhet me ngjytës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ²	205.00	18.00 €	3,690.00 €
1.10.04	Furnizimi me material dhe punimi i caktës për mirëmbajtje më të lehtë të hapësirave me mure të suvaluara të cilat janë të shtrura me pllaka qeramike. Coklla të punohet me pllaka të glazuara qeramike me lartësi 10 cm, me ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përzgjedhur në koordinim me organin mbikqyrës të përcaktuar nga investitori. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngjicave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjytja e pllakave të bëhet me ngjytës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus ose prodhues me karakteristika të ngjashme, me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40 ose prodhues me karakteristika të ngjashme. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25 ose prodhues me karakteristika të ngjashme.	m ¹	125.00	5.00 €	625.00 €
1.10.05	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të jashtme tek hyrjet në objekt (dy hyrjet kryesore), mveshja e rampave/pjerrinave me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë të përpunuar me fiokë. Të gjitha sipërfaqet horizontale, vertikale dhe ato të pjerrëta të vishen me pllaka graniti me trashësi 3 cm duke përfshirë edhe pjesët anësore të shkallëve deri në kufi të përcaktuar në projekt, duke përfshirë caktën me lartësi 10 cm në pjesët ku shkallët bashkohen me fasadën e objektit. Ngjytja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	17.50	50.00 €	875.00 €
1.10.06	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të brendshme duke përfshirë pushimoret, basamakët (shkelëset dhe balloret), caktën e shkallëzuar rreth mureve dhe shkallën e fundit në tërë gjerësinë e kafazit të shkallëve. Të gjitha sipërfaqet të vishen me pllaka të poliruara graniti me trashësi 3 cm (balloret dhe coklla 2 cm). Ngjytja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	34.50	50.00 €	1,725.00 €



1.10.07	Monitimi me materialin dhe mveshja e shkallëve të brendshme me kornizë për tërë pjesë e disnivelet të kateve, me pllaka graniti artificial me sipërfaqe të vrazhdë. Të gjitha sipërfaqet horizontale, vertikale dhe ato të pjerrëta të vishen me pllaka graniti me trashësi 1 cm duke përfshirë edhe pjesët anësore të shkallëve deri në kuotën e përcaktuar në projekt, duke përfshirë caktimin me fortësi 10 cm në pjesët ku shkallët bashkohen me fasadën e objektit. Ngjyja të bëhet me lloq të çimentos me trashësi min.2 cm	m ²	4.00	50.00 €	200.00 €
1.10.08	Monitimi me hidrenat dhe ngjyja e parapetëve të kateve sipërhapësive të gjitha dritareve. Pllakat duhet të ngjiten me ngjës adekuat për kuarc dhe në anën e poshtme duhet të kenë të gdhendura kanalet për pengimin e rrjedhjes së ujit në drojtim të murit. Parapeti aty ku është e mundur të realizohet me 1 pllakë të vetme (pa vazhdime). Në çmim të përfshihet edhe mbyllja e fugave me shiritë ekspandues hidroizolues dhe silikon sanitar. Trashësia 2 cm Gjerësia 25 cm (3 cm duhet të dalin jashtë murit)	m ¹	210.50	15.00 €	3,157.50 €
TOTAL ME TVSH				1.10	11,551.90 €

1.11 PUNËT E ZDRUKHTARISË DYERT, DRITARET DHE ELEMENTET TJERA					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
	Furnizimi i transportit dhe montimi i Dritare PVC 80-85mm, me ngjyrë të bardhë RAL 9016 me hapje dhe kiperim, Qelqi i dritareve: Transparent Termopan 6+14+4mm/Low-E + Argon dryeve: Transparent Termopan 4+12+4+12+4mm/Low-E + Argon Paneli termoizolues: STADUR FB-4 Aluminium Sandwich element nga laminalet e alumini me trashësi 1 mm me mbushje. Punimi i dritareve duhet të bëhet sipas skemës dhe përshkrimit. Produktuesi (Solamander, Aluplast, Trocal, Rehau apo ndonjë prodhues tjetër me karakter të ngjajshëm)."				Qelqi i
1.11.01	POS DO-03 - Derë dykrahëshe PVC me mbidritë Dimensionet: 240x270 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë	copë	1	650.00	650.00
1.11.02	POS DO-04 - Derë dykrahëshe PVC Dimensionet: 100x180 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë	copë	1	180.00	180.00
1.11.03	POS W-01 - Dritare PVC Dimensionet: 125x215 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë	copë	32	265.00	8,480.00
1.11.04	POS W-02 - Dritare PVC Dimensionet: 130x215 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë	copë	18	280.00	5,040.00
1.11.05	POS W-03 - Dritare PVC Dimensionet: 100x120 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë	copë	1	130.00	130.00
1.11.06	POS W-05 - Dritare PVC Dimensionet: 150x60 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë	copë	1	85.00	85.00
1.11.07	POS W-05 - Dritare PVC Dimensionet: 270/180cm. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë	copë	40	450.00	18,000.00
	Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme për shumë qëllime. Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Paneli: H3D Multi Purpose Door me mbushje nga lëshi mineral - me trashësi 45 mm. Korniza e derës: dy pjesëshe e kombinuar - nga korniza këndore me ankerë dhe dipila dhe kontra-kornizë Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak standard të zgjatur vertikal dhe profil për cilindër Mantëshat: 3 pjesësh për pesha të mëdha Ngjyra: E kaltë (Ngjajshëm me dyert ekzistuese) Mbyllësi hidrolik Standard				
1.11.08	POS DO-02 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 100x200 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë	copë	2	350.00	700.00
	Derë metalike. Korniza dhe struktura e derës metalike e punuar me shufra metalike katrorë 5 x 5 cm që përbejnë kornizën dhe rrethet me shyllat e do 1 m dhe trau i mesit shtangues horizontal. Mveshja e kornizës me laminalet 3 mm ne te dy anet dhe mbushje lëshi mineral. Me goma izoluese EPDM përreth kornizës dhe sipërfaqe të rrafshta. Ngjyra e derës dhe profileve: Antracid Dorëzat: jekoradive.				
1.11.09	POS DO-01 - Derë dykrahëshe Dimensionet: 100x240 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë		1	360.00	360.00



	Dritare metalike. Korniza dhe struktura e derës metalike e punuar me shufra metalike kaltrre 5 x 5 cm që përbejnë kornizën. Me gama izoluese EDPM përreth kornizës dhe sipërfaqe të rratshta. Qelqi i dritareve: Transparent Ngjyra e derës dhe profileve: E bardhë - RAL 9016.				
1.11.10	POS W-04 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 125x60 cm. Dizajni sipas skemës së zdhukhtarisë	copë	3	200.00	600.00
TOTAL ME TVSH				1.11	34,875.00 €

1.12 PUNËT E FASADËS					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
1.12.01	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës termoizoluese të tipit StoTherm Vario nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem prodhues tjetër i ngjashëm dhe me karakteristika të ngjajshme Sistemi StoTherm Vario ose prodhues me karakteristika të ngjajshme, duhet të realizohet me shkrasat si në vijim: • Pastrimi i Fasades ekzistuese me leres me presion • Lyerja bazë StoPrep Contact ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Tipla plastike • Ngjithës StoLevell Uni ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Termoizolim Austrotherm EPS ose prodhues me karakteristika të ngjajshme, AF - t=10cm, N4 • Rrjetë Armimi Sto-Glasfasergewebe, ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Dy shtresa masë armuese StoLevell Uni ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Lyerja bazë StoPutzgrund Nature ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Uaç struktural organik Stoispolit Kratz K 2.0 mm ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Ngjyrë akilike Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, ronderat termoizoluese, listelat dilatuese (anputzleiste) për dritare dhe dyer, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e diletimit në fasadë, mbajtësit konzollë për dritare dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m ²	1,650.0	22.00 €	36,300.00 €
1.12.02	Furnizimi me material dhe punimi i caktës dekorative nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër të ngjashëm të prodhuesve tjerë. Caktës termoizoluese duhet të realizohet me shkrasat si në vijim: • Pastrimi i Fasades ekzistuese • Lyerja bazë StoPrep Contact ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Tipla plastike • Ngjithës - masë hidroizoluese StoFlexyl ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Termoizolim Austrotherm XPS 30 t=8 cm • Rrjetë Armimi Sto-Glasfasergewebe ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Dy shtresa masë armuese StoFlexyl ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Lyerja bazë StoPutzgrund Nature ose prodhues me karakteristika të ngjajshme • Uaç dekorativ shumëngjyrësh StoSuperlit K 2.0 mm ose prodhues me karakteristika të ngjajshme Caktës duhet të realizohet nga kuta ±0.00 deri në kuotën -0.50 ose rreth 1.5 cm thellësi në nivelin e trotuarit të përfunduar për të shmangur ekspozimin nga uljet e mundshme të trotuarit. Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, ronderat termoizoluese, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e diletimit në fasadë, dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m ²	195.0	20.00 €	3,900.00 €



1.12.03	Furnizimi dhe montimi i pikoreve nga alumini me trashësi 2 mm për të gjitha dritaret e jashtme në fasadë. Gjerësia e pikores duhet të jetë së paku 28 me kusht që pikorja të jetë së paku 3 cm jashtë fasadës. Materiali: Alumin i plastifikuar Ngjyra: E hirtë - RAL 7016 Matt Në çmim të përfshihet edhe goma izoluese vetngjilëse EPDM ose prodhues me karakteristika të ngjashme për mbyllje të fugës mes pikores dhe profilit të dritares, kapakët skajor, mbajtësit konzollë në distancë jo më të madhe se 50 cm dhe të gjitha mjetet tjera të nevojshme për fiksimin e pikorëve.	m ^l	53.5	10.00 €	535.00 €
TOTAL POZICIONI			1.12	40,735.00 €	

1.13 PUNËT E KULMIT TË PJERRËT DHE LLAMARINËS					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA me tvsh
